

Murrash, Gjeto, Gjetan, Tetë dhe Vogël
Si t'i interpretojmë dhe t'i përkthejmë
disa emra njerëzish të Mesjetës së Arbërit

**Murrash, Gjeto, Gjetan, Tetë and Vogël – how to understand and
translate some medieval Albanian names.**

Abstract: *The names above mentioned have been used for centuries in Albanian. Yet, little is currently known by their bearers and scholars alike about their origin and meaning. Author Ndreca tries to shed more light on the origin of such names in Albanian explaining their meaning and attempting to possibly set a date for them in history. So Murrash is the Albanian version for lat. Maurus, (Eng. Morris), whereas Gjeto and Gjetan match with lat. Vitus and Vitalis; Tetë stands for Octavius and to finish, Vogël for lat. Minor. In his essay, Ndreca maintains that much is owed to the Benedictine monks who publicised the cult of St Maurus, St Vitus as well as St Gall, with the latter sounding in Albanian as Gjelosh. In order to succeed in spreading the Gospel, the author believes that the Benedictines translated the names of the patron saints of their order. Apparently only in Albanian the name Vitus is translated as Gjetë, meaning 'life', whereas in other main European languages either the Latin or Italian versions are used for it.*

Names were translated even before the Middle Ages the author argues. Such is the case for Tetë, the numeral eight in Albanian matching with lat. Octavius. In the appendix, the essay focuses on a string of hypocoristic names such as Llesh, Lekë, Zekë, Gjekë etc. In this group the author believes also belong Kokë and Dakë, Albanian versions standing for Saints Cosmas and Damian much venerated throughout the Albanian territories during the Byzantine rule and later as well.

Keywords: *Maurus, Vitalis, Murrash, Gjetan, hypocoristics, Albanian palatalization.*

Materialet arkivore të Mesjetës sonë mbi të cilat bazohen studimet albanologjike janë kryesisht në latinisht, në greqishten bizantine, në italishten vulgare, sllavisht, spanjisht dhe osmanisht.

Është e kuptueshme se në të gjitha këto gjuhë logotetëve ose noterëve u është dashur që përveç se të përkthejnë emrat e njerëzve dhe të vendeve – traditë kjo e njohur – të përshtasin edhe ato tinguj të shqipes që gjuhët

e tyre përkatëse nuk i kanë, gjë që e bën më të vështirë përcaktimin e kuptimit të emrave.

Kështu që studiuesve dhe përkthyesve sot u duhet të kthejnë rishtas shqip emrat që nga shqipja janë përkthyer në këto gjuhë. Përveç kësaj, është e dobishme të shpjegohet edhe kuptimi i këtyre emrave, qofshin këta njerëzish apo vendesh. Për këtë kategorinë e fundit, kontributi i albanologut Peter Bartl në këtë drejtim është i paçmueshëm, veçanërisht përsa i përket përkthimit të toponimeve¹.

Në këtë studim ne do të ndalemi tek përkthimi shqip si edhe kuptimi i disa emra njerëzish që dalin ndër dokumentet mesjetare të Arbërit.

Maurus – Murrashi

Emri lat. *Maurus*/it.*Maurizio* në shqip përkthehet si «Murrash». Ky emër në zanafillë shënonte ngjyrën e lëkurës së individit, ngjyra e murrme. Në Mesjetë ky etiketim përdorej gjerësisht për të shënuar të ashtuquajturit *Maurovlachi*, *Vllehtë e murrme*, për praninë e të cilëve në territorin e Arbërisë mesjetare flet edhe Milan Šufflay².

Ndër dokumente gjegjë vendndodhjen e të paktën dy kishave kushtuar këtij shenjt në territorin e Arbërisë.

E para dëshmi na vjen nga një dorëshkrim i Atë Serafino Cerva-ës, dominikan raguzan, në të cilin thuhet se ipeshkëv Marku i Ulqinit ua lëshoi kishën e Shën Murrashit për mbarështim dominikanëve në vitin 1258³. Ky vend sot, me gjasë mjaft të madhe, i përgjigjet toponimit Sutomore, afër Tivarit në Mal të Zi, sadoqë Milan Šufflay mendon se ky toponim ka një etimologji tjetër⁴.

Dëshmi të mëtejshme, për një tjetër kishë, na jep imzot Mark Skura në

1 P. BARTL (herausgegeben und bearbeitet von), «Albania Sacra: Geistliche Visitationsberichte aus Albanien 1: Diözese Alessio», tek *Albanische Forschungen*, 26, 1, Wiesbaden 2007.

2 M. ŠUFFLAY, *Serbët dhe arbërit*, Berk, Tiranë 2022, kreu 19, 21.

3 «Primo igitur anno 1258 Marcus Episcopus Dulcinensij Ecclesiam S. Mauri ob causas in suo diplomata sequenti tenore efformato significatas eisdem concessit.», ARCHIVUM FRATRUM PRAEDICATORUM, Santa Sabina, Romë, *Liber PP, Secunda Pars, Monumenta Congregationis S. Dominici de Ragusio Ord. FF Praedicatorum*, f. 390- 473r (S. CERVA, ca. 1756), 400r.

4 Krhs., Sutomore < Sanctus Maurus; Supetar[sk] < Sanctus Petrus si edhe toponime të ngjashme përgjatë bregdetit dalmat. Në fakt, M. ŠUFFLAY është i mendimit se «Sutomore» vjen nga «Sancta Maria». Shih: M. ŠUFFLAY, *vep. cit.*, kreu 22. Por, reduktimi i diftongut /au/ tek emri «Maurus» në një /o/ tek emri i përngjitur «Sutomore», duket se na jep ne të drejtë. Për më tepër, krhs., lat. *taurus* > it. *toro*. Toponime të tilla nuk gjegjë vetëm gjatë bregdetit dalmat por edhe në territorin e Shqipërisë së sotme. I tillë është Kodër-Shupal, ndërmjet Bendës dhe Zall Bastarit, në verilindje të Tiranës. Për më tepër rreth ipeshkvisë së Bendës, shih: D. FARLATI – J. COLETI, *Illyricum Sacrum*, Venetiis 1817, tom. VII, 400-405.

një relacion dërguar Propagandës Fide në vitin 1641. Mes tjerash pohon se një kishë e Shën Murrashit gjendet në Priskë të Madhe⁵.

Shën Murrashi qe një nga nxënësit e Shën Benediktit, siç na rrëfen benediktini Ivan Ostojić, prandaj të përhapurit e kultit të tij lidhet me rregullin e benediktinëve dhe abacitë e tyre⁶.

Benediktinët qenë shumë të fuqishëm në Arbëri dhe këtë na e dëshmojnë jo vetëm emrat e manastireve të tyre por edhe pasuritë që kishin. Kështu, abacia e Ndërfanës [Trifandena] në Mirditë kishte komendë të vetën manastirin e Santo Spirito-s në Ortona, Itali të paktën për një periudhë kohore. E humbi këtë në vitin 1449, në kohën kur abat i Ndërfanës ishte Pali, siç lexohet në një bulë të papës Nicolò V, dhe kur kërcënimi i osmanëve në Arbëri ishte bërë gjithnjë e më i madh. Tashmë kishin filluar luftrat e Gjergj Kastriotit⁷.

Ky është pikërisht abati Pal (*nuntius noster*), nunc apostolik i Papës në Arbëri, i urdhrat benediktin të cilit Selia e Shenjtë i jep një lejekalimi, për të, për të afërmit dhe kalorësit e tij⁸. Abati Pal, mbiemri i të cilit nuk del, ishte i dërguari i papës Kalistit III për kryqëzatën kundër osmanëve në Arbëri, Dalmaci, Rashë dhe Greqi⁹.

Abaci tjetër benediktine ishte edhe Shna Prendja e Kurbinit, në dioqezën e Krujës. Pikërisht abatit të Shna Prendes i kërkohet nga Selia e Shenjtë që kishën e Shën Gjergjit t'ua kalojë nën juridiksion benediktinëve të Shën Marisë së Ndërfanës sepse murgjit në Ndërfanë nuk kishin me se të jetonin tashti që kuvendi ishte dhunuar dhe djegur nga turqit ([...] quod a Teucris

5 21) «Ka kishën e Shën Mauricit, të vendosun në tokën e Priskës së Madhe, të plotë, në gur të gjallë; motit abaci, sot pa rentë e pa prift. Të gjithë turq; frymë të krishtena – 10.», I. ZAMPUTI (përkth. dhe përgat.), «Relacion i Mark Skurës drejtue Kongr. Prop. F. mbi vizitën e kryeme nëpër dioqezet e Shqipërisë së Mesme, 20 dhjetor 1641», te *Relazione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII*, vëll. II (1634-1650), Tiranë 1965, 229.

6 I. OSTOJIC, *Benediktinci u Hrvatskoj i ostalim našim krajevima*, Split 1963, vëll. I, 391.

7 815 (528) 1449, gennaio 25, a. II., Roma S. Pietro.
NICOLÒ (V) «ad futuram rei memoriam»: dietro preghiera dell'abate di S. Spirito di Sulmona e del priore e dei monaci di S. Spirito fuori le mura di Ortona, toglie a Paolo, abate di S. Maria di Trifandena dell'ordine di S. Benedetto «qui et asserebat pro Romana Ecclesia ad Albanie et Turchie partes eundo et inde redeundo gravia labores et pericula sustinuerat», la commenda di S. Spirito di Ortona e restituisce il monastero al pristino stato, dandolo nuovamente ai monaci che ne erano stati scacciati da Paolo. Shih: T. LECCISOTTI (a cura di), *Abbazia di Montecassino, I registi dell'Archivio*, vol. III, Roma 1966, 337.

8 A. THEINER, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium*, tomus primus, Romae 1863, DCIII, 426.

9 M. SCIAMBRA, G. VALENTINI, I. PARRINO, *L'Albania e Skanderbeg nel piano generale di crociata di Callisto III (1455-1458)*, Badia di Grottaferrata, 1967, 125.

invasum et combustum extitit [...]»¹⁰.

Abati benediktin mbante titullin lat. *dominus*, prej të cilit në shqip kemi trashëguar shkurtimein «dom». Na e dëshmon këtë toponimi *Domgjon*, në Mirditë.

Mrkša - Murrash

Nëse do të nevojitej ta përkthenim – veprim jo i këshillueshëm për dokumentet historike – edhe emri serbisht Mrkša do të përkthehej shqip si «Murrash». Le të kujtojmë këtu Mrkša-n sundimtarin e Kaninës e të Vlorës, dhëndërr i Balshës II. Ky Mrkša – *Murrashi* është ai që ka zëvendësuar qefalinë e Kaninës, Kastriotin, për të cilën kemi folur tjetërkund¹¹. Fisniku Mrkša është i martuar me Ruginën, vajzën e Balshës II.

Rugina - Regjina

Edhe emri i kësaj fisnikeje si shqip ashtu edhe serbisht duhet interpretuar si «Regjina».

Arsyet për këtë janë se në *povelje*-t, dokumentet në serbisht që ky çift i dërgon Raguzës, emri i kësaj shkruhet me një [g] të paqielzorizuar ende. Ndërsa përse i përket rrokjes së parë të emrit të saj /Ru-/, lexuesi le të krahasojë emrin *Gjergj*, i cili serbisht në dokumentet e kësaj kohe dokumentohet si *Gjin*. ГИРГА, ГИРГА¹². Një shembull tjetër është edhe emri *Teodor* që rregullisht na del ndër *acta*-t mesjetare serbe si Тудр-*Tudr*¹³.

Pra zanorja [u] serbisht, të paktën në këto shembuj, i përgjigjet zanores [e] të këtyre emrave të përveçëm, fakt që na shtyn të mendojmë se edhe në rastin e emrit *Ruginë* mund të jetë i vërtetë. Mund të shtojmë se përveç kësaj *Ruginës/Regjinës*¹⁴ këtu, një emër i tillë nuk duket se del tjetërkund në arealin e sllavëve jugorë.

Ky çift bashkëshortor i përket padyshim zonës së ndikimit kulturor adriatikas. Po përmendim kalimthi se letrat Republikës së Raguzës, Mrkša dhe Rugina i dërgojnë nëpërmjet njerëzve të tyre të besuar.

Kështu, disa nga emrat e këtyre kasnecëve janë: Gjergj Kavedati Vlonjati

10 Po aty, DCII, 425.

11 A. NDRECA, *Emni «Kastriot» në një letër serbisht të vjetit 1368*, tek «Shejzat-Pleiades» 3-4, Tiranë 2018, 18-19.

12 L. STOJANOVIĆ, *Stare srpske povelje i pisma, Dubrovnik i susedi njegovi*, knjiga I, prvi deo, Beograd – Sremski Karlovci, 1929, dok. 104, 105; f. 104-105.

13 F. MIKLOSICH (edidit), *Monumenta serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnia, Ragusii*, Vienna 1858, XI, XXIII.

14 Edhe M. Šufflay është i mendimit se emri duhet interpretuar si *Regina* por nuk i shpjegon arsyet. Krhs., L. THALLÓCZY – C. JIREČEK – E. ŠUFFLAY (collegerunt et digesserunt), *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, (tash e tutje AA.) II, Vindobonae 1918, dok. *461, 528c, 594, f. 114, 138, 166.

(i letrës së 12 dhjetorit 1401); Kostë Bardhi Vlonjati (i letrës së 2 shkurtit 1402); Jani Jani protonotari (letra e 2 qershorit 1402; letra e 24 janarit 1406); Franko Josifi hebreu (letra e 8 dhjetorit 1416)¹⁵.

Vito – Gjeta

San Vito në shqip përkthehet si Shën Gjeto. Në shqip ka ardhur si përkthim më se i drejtë i emrit të përgjithshëm «jetë». Përsa i përket kalimit të gjysmëzanores [j] në [j], le të krahasojmë emrat që gjejmë në të njëjtën kohë te Kadastrit i Shkodrës (1416) i familjes së njohur Jonima. Ky mbiemër në këtë burim historik na del herë *Jonima* dhe herë *Gionima*, *Geonema*¹⁶, gjë që na dëshmon për prani të njëkohëshme të këtyre dy trajtave¹⁷. Po ashtu, në të njëjtin dokument gjejmë herë *Jon* dhe herë *Gin*, një trajtë kjo e emrit *Gjon*¹⁸. Mbi këtë dukuri fonologjike, të [j] në pozicion nistor që e ka burimin nga një *IE. /i/ ose nga një /i/ e latinishtes është shprehur prof. Shaban Demiraj, i cili mbështetet tek autorë pararendës¹⁹.

Përkthimi i emrit *Vito* si *Gjeto*, ku siç vërehet është ruajtur edhe /-o/ e emrave mashkullorë italisht, ngaqë shqipja e interpreton si një thirrore që i është pasvënë emrit (*O Gjetë!* > *Gjet-o!*)²⁰, sjell me vete disa ndërlikime të mëtejshme.

Së pari na tregon se etërit e kishës arbërore i kanë përkthyer emrat e huaj shqip, sadoqë ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë me siguri se kur; së dyti na tregon se shqipja vërteton domethënien e variantit latinisht *Vitus*, na pohon se ky emër buron nga fjala «jetë».

Përsa i përket kishave kushtuar Shën Gjetos në territorin arbër të Mesjetës mund të themi se një e tillë gjendej në afërsi të Shkodrës, në drejtim të veriut, jo larg fshatit Vrakë, në Pultin e Poshtëm siç njihej në mesjetë kjo krahinë e cila sot quhet Mbishkodër. Këtë të dhënë na e përcjell një krizobulë e carit Stefan Dushan, nëpërmjet së cilës, kishës së Shenjtërve Mëhill dhe Gabriel që cari kishte ndërtuar në Prizren, i dhurohen disa fshatra arbërore. Në këtë dokument, car Dushani na përcjell emrat dhe kufijtë e fshatrave që

15 L. STOJANOVIĆ, *vep. cit.*, dok. 401, 402, 403, 406, 410; f. 397, 398, 399, 401, 405.

16 Krhs., /g/>/gj/ te K. TOPALLI, *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 2004, 189.

17 Krhs., P. DAKA, «Rreth disa antroponimeve të hershme shqiptare», te *Studime Filologjike*, Tiranë 1984, nr. 3, 149.

18 F. CORDIGNANO, *Onomasticon del catasto veneto di Scutari e registrum concessionum*, Stabilimento grafico «Carnia», Tolmezzo 1945, f. 30-31; 34-35.

19 Sh. DEMIRAJ, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1996, 197-199.

20 Krhs., M. LAMBERTZ, *Die Volksepik der Albaner, der Zyklus von Mujo und Halil*, tek «Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl Marx Universität Leipzig», 4 Jahrgang 1954-56, 245.

detyrohen t'i shlyejnë taksa kësaj kishe të re në Prizren.

[...] Я оу долнем Пилотѣ да даю цркъви свиле стотисоукъ вола сто перпер. Бело Коупѣл'ник и цркъвь свѣта Богородица, а мегта моу ѿ Подгорн оу Шимевнх доубь, и право нне почтокъ подь оубьль и под Харист'но брьдо на Соудноу оулицоу, ѿ тоудоу право нне поле на стоуденьць Польбар и право ннц поле на белн поутъ како нма мегие свѣтлымъ Брачемь и поутемь велимь право ѿ цркъвь свѣтаго Кнт'да [...].²¹

Si emër, *Gjeto* mund të themi se nuk është i rrallë në dokumentet mesjetare. Del mjaft shpesh edhe në *acta*-t e Dalmacisë ku merr trajtën mashk. *Vita*. Fjala vjen, kështu quhet frati françeskan nga Kotorri, kryemjeshtrë ndërtues i manastirit të Deçanit.

Фрадъ Бнда, мали братъ, протоманиторъ нзъ Котора [...].²²

Sidoqoftë, prap më të hershëm se këtë kemi Gjeton, prift shkodran (Vitus, presbyter Scodrensis), i cili përmendet në vitin 1251²³ e disa të tjerë²⁴.

Shkodranët në Venedik e kremtonin festën e Shën Gjetos më 15 qershor. Në prag të kësaj feste, më 14 qershor, dozha i Republikës vizitonte kishën kushtuar këtij shenji, dhe në atë kremtim merrte pjesë edhe *Shkolla e Arbërve*²⁵.

Një fakt që tërheq vëmendjen e që mund të vërtetohet lehtësisht është se në gjuhët më të njohura europiane ky emër njihet sipas variantit latin ose italian *Vitus/Vito*, dhe vetëm shqipja e ka të përkthyer si *Gjeto*.

Nëpër këtë proces qiellzorizimi kanë kaluar edhe emra të tjerë familjesh. I tillë është edhe ai i familjes Juka²⁶. Ky mbiemër del në Shkodër ende sot e

21 *Kurse në Pultin e Poshtëm t'i japin kishës 100 mijë krimba mëndafshi 100 hiperpera* [ose t'i japin 100 perpera. M. Šufflay]. *Fshati Koplík dhe kisha e Shenjtës Virgjër, kufijtë e të cilit fshat nga Podgora deri te Lisi i Simonit, dhe drejt poshtë përroit* [Përroit të Thatë?] nën ubël dhe nën malin Krastën te sheshi i Gjykatësve [Kuvendi/Logu i Burrave?], prej andej drejt poshtë fushës te kroi i Polvarit [Palvarit] dhe drejt poshtë fushës te rruga e madhe siç i ka kufijtë me Vrakën dhe nëpër rrugën e madhe te kisha e Shën Vitit. tek AA., II, dok. 46, f. 12. Toponimi serbisht «Podgora» i përgjigjet toponimit shqip *Rranza/Rrëza* < **Rranjēza* por këtu nuk u pa me vend që të zëvendësohej me fjalën shqip meqenëse ende sot e kësaj dite ajo zonë e Mbishkodrës quhet Podgorë, fjalë për fjalë: *Nënmal*.

22 *Frat Vita, vëlla i vogël, kryemjeshtrë nga Kotorri* [...] te F. MIKLOSICH (edidit), *Monumenta serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnia, Ragusii, Viennae* 1858, XCI, 109.

23 AA., I, Vindobonae 1913, dok. 205, f. 61.

24 *Vita, vir albanensis prope Ragusium* (1323); *Vita, diaconus Antibarensis Scodrensis* (1323) tek AA., I, 527 c; 687, 689; *Vitus (Βήτωρς)*, monachus Dyrrhachiensis (1389), AA., II, 142.

25 L. NADIN, *La Matricola della Scuola degli Albanesi*, Berk, Tiranë 2022, 64.

26 Juka > Gjuka > Đukanović. (Shembulli dëshmon evolucionin fonologjik, jo përkatësinë etnike.)

kësaj dite por edhe në Dobrec, Shestan²⁷, sot Mal i Zi.

Junius – Çun

Emri latinisht *Junius* ka kuptimin «i ri» dhe kalimi i këtij emri të përveçëm në shqip si *Çun*, duke mbetur semantikisht pothuajse i njëjtë, duket se i detyrohet pikërisht asaj dukurie fonologjike që përmendëm në rastin e emrit *Gjeto*²⁸. Ky emër, përveç njeriut shënon edhe muajin qershor, it. *Giugno*. E në të vërtetë, arbëreshët përdorin pikërisht [dʒun-i] për këtë muaj²⁹.

Në fakt [j] e latinishtes duhej të kishte dhënë [j] në shqip dhe jo [tʃ] por kalimi ka ndodhur duke u përshkuar nga dialekti raguzan/venedikas³⁰. Nga ana tjetër, bashkëtingëlloret mbylltore [dʒ] dhe [tʃ], e para e zëshme dhe e dyta e shurdhët, e zëvendësojnë njëra-tjetrën lehtësisht në shqip³¹.

Kështu quhet një arbër nga Ulqini, *Junius de Sevasto de Dolcigno*, i cili del në një dokument të vitit 1359. Po i njëjti person, përmendet rishtas por tashmë me një grafi tjetër (Çugno³² de Seuast) në vitin 1363, në italishten raguzane³³.

Junius de Seuasto de Dolcigno përmendet në dokumentet raguzane në lidhje me një brez argjendi që kishte lënë peng në Raguzë si kundërpagesë. Një praktikë e tillë ka qenë mjaft e përhapur sepse në vitin 1368, Strazimir dhe Gjergj Balsha dërgojnë në Raguzë të besuarin e tyre Dimitër Dabretikun Ulqinakun³⁴ që ky të merrte brezin e artë të Strazimirit, lënë peng atje prej këtij princi³⁵. Rregullat për kthimin e mallit të lënë peng do të përcaktoheshin në vitin 1463 nga Benedetto Cotrugli, raguzan në një vepër

27 Gj. DABAJ, *Shestani*, vëll. II, Ulqin-Tiranë-Prishtinë 2004, 13.

28 Krhs., Sh. DEMIRAJ, *vep. cit.*, 197-199.

29 *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Università degli Studi di Napoli L'Orientale, vëll. I, 2007, harta 135.

30 Krhs., ZAMARACHI (Giergi-), 59/a; oggi nome di un piccolo villaggio a *Rrjoll*, detto *Çamarrat*; ZAGNI (Zorzi-), 89/b [...]; cfr. *Čanj*, luogo presso *Spiča*., tek F. CORDIGNANO, *Onomasticon del Catasto Veneto di Scutari e registrum concessionum*, Tolmezzo, 1945, 65. Për më tepër rreth ortografisë raguzane, krhs., emrin e familjes tivarase *Zare/Çare/Giare* tek M. ŠUFFLAY, *Serbët dhe Arbërit*, Berk, Tiranë 2022, 167.

31 K. TOPALLI, *vep. cit.*, 179. Krhs., *xhufkë – çufkë*, te *Fjalor i gjuhës shqipe*, Instituti i Shkencave, seksioni i gjuhës e i letërsisë, Tiranë 1954.

32 Shqipto: [dzupno] ose [tsupno].

33 AA., II, dok.143, 36.

34 Krhs., «1411 III 24, Venetiis. [...] Nunc uero comparauit Sclaua uxor quondam Dimitrij Dabri (?) de Dulcigno ostendes quoddam testamentum [...]» tek I. VALENTINI, *Acta Albaniae Iuridica*, tomus II, Rudolf Trofenik, München 1973, dok. 358, 38.

35 L. STOJANOVIĆ, *vep. cit.*, dok. 105, f. 105.

botuar njëqind e dhjetë vjet më vonë³⁶.

Emër tjetër muaji që përdorej edhe për njerëzit është *Maj*, lat. *Maio*. Kështu quhet edhe ipeshkvi i Kotorrit (*Ego Maio*), i cili bashkë me prelatë të tjerë, më datën 20 maj 1166 shuguron altarët e kishës së Shën Trifonit në Kotorr. Nëse evolucioni fonologjik që përmendëm më lart është i drejtë, del se emri i përdorur për njeriun në gjuhën shqipe në këtë rast është *Maç*, dhe në fakt shembujt nuk mungojnë. Këtë e gjejmë si mbiemër familjeje në plot raste nëpër territorin e Shqipërisë së sotme³⁷.

Atë ditë për shugurimin e altarëve të katedrales së Shën Trifonit në Kotorr, ipeshkëv *Maçi* kishte thirrur: Lazrin, ipeshkëv të Arbërisë; Martinin, ipeshkëv të Drishtit; Gjonin, ipeshkëv të Ulqinit; Pjetrin, abat (arqimandrit) të Shën Shirgjit e Bahut e të tjerë³⁸.

Është interesante të vihet në pah gjithashtu se lisi që zbukurojnë më 1 maj, për nder të pranverës, me ëmbëlsira dhe shirita shumëgjyrësh banorët e Perastit, në Mal të Zi (territor ku ka ndikuar kultura raguzane/ venedikase), quhet *Mađ* [maɟ]. Në atë datë, perastinët caktojnë dhëndrrin më të fundit të vitit pararendës për të zbukuruar një rremb lisi që e ngulin përpara kishës së Shën Nikollës, në qendër të qytezës³⁹.

Në përfundim, shtojmë se një interpretim që zgjon kureshtje i emrit *Çun* jepet nga S. E. Mann, i cili e përmend si fjalë të dalmatishtes⁴⁰. Po ashtu, te ky emër ndalet gjatë edhe E. Çabej i cili përmbledh dhe diskuton rreth mendimeve të gjuhëtarëve të tjerë. Ndër to bie në sy mendimi i M. Lambertz-it i cili beson se emri është i gurrës ilire, me burim prej emrit *Zunus* që del në një mbishkrim në Livno, në Bosnje⁴¹. Nga ana tjetër fjalori etimologjik i shqipes nuk shprehet rreth zanafillës së këtij emri⁴².

36 B. COTRUGLI, *Della mercatura et del mercante perfetto*, IV, Venegia, 1573, 36.

37 Saktësojmë se *Maçi* si mbiemër familjeje mund të jetë krijuar edhe me një rrugë tjetër. Krhs., *Andreas Makelari, civis Dyrrhachiensis (1246)*, tek AA, I, dok. 181, f. 56. Është e dukshme afërsia e mbiemrit *Makelari* me toponimin Maqellarë, Dibër, gjë që dëshmon se jo të gjithë emrat me prapashtesën /-llarë/ burojnë nga turqishtja, kur dimë se ky emër vetjak shënohet rreth dy shekuj para pushtimit osman të Arbërisë. Tjetër, jo larg nga Maqellara, në Tetovë, na del emri i fisit shqiptar *Lekallarë*. Shih: P. DAKA, *vep. cit.*, 148. Mbetet për t'u shqyrtuar nëse *Lekallarë* është mbiemër i zanafillës ashtu si *Makelari* apo jo.

38 I. K. SAKCINSKI (izdaje), *Codex Diplomaticus regni Croatiae, Slavoniae et Dalmatiae*, dio 2, knjiga 3, Zagreb 1875, XCV, 73.

39 <https://www.aktuelno.me/magazin/perast-tradicionalno-okitili-mad-u-slavu-proljece-radosti-zivota/>

40 «The Dalmatian personal name Ceunus has a feminine counterpart Ceuna, with a possible equation in Albanian çun 'boy'». Shih: S. E. MANN, *An Albanian Historical Grammar*, Buske, Hamburg 1977, IV.

41 E. ÇABEJ, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, bleu III, Tiranë 1987, 142-143.

42 K. TOPALLI, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e studimeve albanologjike, Tiranë 2017.

Vitale – Gjetan

Një zhvillim i mëtejshëm i emrit latin *Vitus* është *Vitalis*. Në shqip këtij i përgjigjet pikëpërpikë emri *Gjetan*, ku prapashtesa /-an/ thekson vetinë themelore të emrit fillestar⁴³ dhe, në rastin e këtij emri, shënon një individ plot jetë e gjallëri.

Përhapja e kultit të Shën Murrashit, të Shën Gjetos e të Shën Galit edhe në territorin e Arbërisë mesjetare duhet lidhur me benediktinët dhe me abacitë e tyre në bregdetin e Adriatikut lindor, duke përfshirë gjithë Dalmacinë. Në fakt, është me vend të përmendim këtu se edhe kishëza që mbarështon në Raguzë famullitari arbër Sergji në vitin 843 dhe ku prifti tjetër arbëror Gjoni kishte lënë amanet të ruhej Shpërgani i Krishtit Foshnje, i është kushtuar pikërisht Shën Gjetos⁴⁴.

Ashtu si *Gjetë* > *Gjetan*, në shqip kemi të krijuar edhe *Llesh* > *Lleshan*⁴⁵.

Gallo – Gjelosh

Parë nën dritën e ndikimit benediktin ka kuptim që edhe emrit *Gallo*, nga emri i shenjtorit it. *San Gallo*, t'i përgjigjet shqip emri *Gjelosh*. Duket qartë se edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një përkthim që ka ruajtur edhe semantikën e emrit⁴⁶. Mendojmë se me zanoren /-o-/ tek prapashtesa /-osh/ ka vepruar e njëjta dukuri si tek emri *Gjeto*, dhe se kjo është pasqyrim i zanores /-o-/ i variantit fillestar, ndërsa /-sh/ është prapashtesë zvogëluese.

Që emri *Gjelosh* nuk është pagan na e tregon më së miri një gur varri në formë kryqi i cili u gjet në vitin 2019 gjatë punimeve në kishën e Shna Prendes në Balldren, Lezhë⁴⁷.

Sadoqë nuk përbën një garanci të drejtpërdrejtë, prapsepapë, duke vërejtur të gjitha këto fakte që lidhen me emra shenjtorësh të urdhrat benediktin të përkthyer shqip – tregues i vullnetit të këtyre rregulltarëve për t'i folur në gjuhën amtare besimtarëve – është e logjikshme të mendojmë se edhe katekizmi i tyre mund të jetë zhvilluar në shqip.

Për më tepër, lidhur me ndikimin e benediktinëve dhe rolin e tyre në

43 A. XHUVANI — E. ÇABEJ, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962, 14.

44 A. NĐRECA, *Sacer Panniculus Christi – Shpërgani i Krishtit Foshnje që la në Raguzë Gjon Arbnori në vitin 843*, te «Shejzat», 3-4, dhjetor 2020, 51-66.

45 A. KOSTALLARI — M. DOMI — P. DAKA — S. MANSAKU (përgat.), *Fjalor me emra njerëzish*, 8 Nëntori, Tiranë 1982.

46 Krhs., «Gjelosh m. “gjel”, edhe emër burrash.», tek E. ÇABEJ, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, bleu IV, Tiranë 1996, 318.

47 Në gurin gëlqeror në formë kryqi lexohet qartë: «Gielos Marasi, 1813 – 1873». Guri ruhet brenda kishës.

Arbëri na ndriçon me konsideratat e tij historiani Milan Šufflay⁴⁸.

Mendojmë se në këtë mënyrë iu përgjigjëm edhe pyetjes që shtron albanologia Lucia Nadin te zbulimi i saj i fundit «La Matricola della Scuola degli Albanesi», nëse San Gallo ishte një shenjt që arbërit e kishin sjellë me vete në Venedik dhe devocionin e këtyre ndaj shenjtërve të tjerë si San Mauricio apo San Vito, pajtorë të urdhrin benediktin⁴⁹.

Primus / Octavius / Minor – Prengë / Tetë / Vogël

Fakti që emrat e huaj janë përkthyer shqip, ose edhe e anasjellta, nuk duhet të na çudisë aspak. Ka gjasa që kjo rrugë të jetë ndjekur edhe shumë më herët, dhe jo vetëm nga kisha. Na ndihmojnë në këtë rast disa krahasime që mund të bëjmë.

Në një studim kushtuar fshatit Blinisht, në zonën e Zadrimës na është përcjellë epitafi latinisht i Tetë Çekës Midhës, martir i kishës katolike shqiptare, vranë nga osmanët. Përveç variantit shqip, emri i tij na përcillet edhe si *Octavius* në mbishkrimin latinisht⁵⁰. Martiri duhet të ketë qenë fëmija i tetë i familjes Çeka Midha. Duke qenë se në fakt emra të tillë shenjtorësh nuk ishin më të parapëlqyerit në ato shekuj të sundimit osman (XV-XX), nuk mbetet tjetër veçse të dalim në përfundimin se është traditë që na çon në muzgun e lashtësisë, atëherë kur emri *Octavianus/Octavius* duhet të ketë qenë shumë më popullor në trevat tona.

Emra të tjerë që i përkasin zakonisht të numërimit të fëmijëve janë edhe emrat *Prengë*, në lat. *Primus*, si edhe emri *Vogël*⁵¹, në lat. *Minor*.

Emri *Prengë* shfaqet shpesh në dokumentet mesjetare të Arbërit, ndërsa *Vogël*, del i dokumentuar të paktën dy herë si mbiemër shqiptar, me

48 M. ŠUFFLAY, *vep. cit.*, kreu 7, 15, 24.

49 L. NADIN, *vep. cit.*, shën. 3, 60.

50 «TET CEKA / MATYR OCCUBUIT / HIC OCTAVIUS ILLE MIDAS IACET / INCLITUS HEROS / CUIUS PRO CHRISTO / TERRA CRUORE MADET qi shqyp mund të përkthehet: TETË ÇEKA / MARTIR DIQ / KËTU NJAJ TETË MIDHA Â I SHTRËM / KRESHNIK I FAMËSHËM / I CILI PER KRISHTIN / ME GJAK TË VET E RËNI TOKEN.» Shih: G. GURAKUQI, «Blinishti», *LEKA*, Shkodër 1931, vjeti III, nr. 5, 157.

Emri i Tetë Midhës na del së paku në dy dokumente. I pari është relacioni i njohur i imz. Marin Bicit i vitit 1610. I dyti dokument ku përmendet ky martir është një relacion i klerit të Shkodrës dhe i popullit të Barbullushit drejtuar Papës dhe Propagandës Fide për çështjen e kishës së Barbullushit, hartuar prej mëkëmbësit të ipeshkvisë së Lezhës, imz. Kristofan Krythës. Letra është e para datës 20 qershor 1628 dhe dëshmon se të paktën deri në atë vit martiri Tetë Midha ishte ende gjallë. Shih: I. ZAMPUTI, *vep. cit.*, vëll. I, Tiranë 1963, 113, 377.

51 Kujtojmë këtë të ndjerin Pashko Nika (1886-1965), të cilin në Shkodër e njihnin si *Vogël*, nofkë kjo ngjitur nga vetë familja e tij ngaqë ky ishte më i vogli. (Falenderoj për të dhënat z. Neta dhe Luigj Manovi.)

prapashtesë të serbishtes⁵². Po ashtu del edhe latinisht si *Minor*⁵³.

Emri *Vogël* është formuar nga mbiemri mashk. *i vogël* dhe ky nuk është i vetmi shembull. Këtu hyjnë edhe: *i bardhë* > *Bardh*[-yl/-ok]⁵⁴ etj; *i zi* > *Zeshkan*⁵⁵ e prap ndonjë tjetër.

Nuk mund të rrimë pasaktësuar se në rastin e këtyre emrave prej rreshtorë, nuk e dimë me siguri nëse kemi të bëjmë thjeshtë me përkthime në arbërisht të emrave latinisht – dhe nëse është kështu duhet të pranojmë se kemi të bëjmë edhe me një huazim zakonesh – apo mos ka ekzistuar njëkohësisht jo vetëm tek latinët por edhe te popujt e tjerë të Mesdheut zakoni i të quajturit të fëmijëve simbas rradhës së lindjes në familje.

Nga ana tjetër, prania e emrit *Vogël* në Shkodër deri në fund të viteve 1960-të, ku shfaqet si një nevojë e brendshme e sistemit të emërtimeve farefisnore brenda një familjeje na tregon se ndoshta kemi të bëjmë me një traditë origjinale, jo të huazuar.

Antropologu Lewis Henry Morgan, në hipotezën e tretë të tij mbi sistemet e emërtimeve farefisnore, shpreh mendimin se sisteme emërtimi mjaft të ndryshme mund të gjenden edhe në zona gjeografike shumë të afërta, ashtu sikurse edhe sisteme emërtimeve farefisnore mjaft të ngjashme mund të gjenden në zona gjeografike mjaft të largëta ndërmjet tyre prandaj përcaktimi i shtrirjes gjeografike dhe vërtetimi i autenticitetit të kësaj tradite duket tepër i vështirë⁵⁶.

SHTOJCË

Emrat *Gjokë*, *Ndrekë*, *Gjikë*, *Zekë*, *Gjekë* dhe *Lekë* (*Llesh*)⁵⁷ janë hipokoristikë⁵⁸ dhe iu përgjigjen emrave: *Gjon*, *Andre*, *Gjin*, *Zef*⁵⁹, *Gjergj* dhe *Aleksandër*.

Kokë dhe *Dakë* janë dy emra të tjerë, forma përkëdhelëse të emrave *Kozma* dhe *Damian*, të cilët mendojmë se duhen përfshirë në këtë kategori. Sot i gjejmë si patronimë që të dy. *Dakë* gjendet edhe si emër njeriu ndërsa

52 Voglić Gonus (Johannes), pastor Albanensis (1288); Voglić Dragoš, pastor Albanensis (1322), 679, tek AA, I, *511; 679.

53 Minor, archiepiscopus Duracensis, A 87, A 92, A 95; Minor (de Duracio), monachus, dok. 114. AA, II, f. 259, 31.

54 Për më tepër shih: P. DAKA, *vep. cit.*, 142.

55 A. KOSTALLARI — M. DOMI — P. DAKA — S. MANSAKU (përgat.), *vep. cit.*, 31. Të vihet re këtu se edhe emri i përveçëm *Zeshkan* është formuar me prapashtesën /-an/.

56 U. FABIETTI, *Elementi di antropologia culturale*, Mondadori Università, Milano 2010, 357

57 Për më shumë rreth emrit *Lekë/Llesh*, shih P. DAKA, *vep. cit.*, 147.

58 A. XHUVANI – E. ÇABEJ, *vep. cit.*, 64.

59 J. RROTA, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime françeskane, Shkodër 2006, 225.

Kokë mbijeton si emër i përveçëm tek legjendat e burrit të urtë *Kokë Malçi*, këshilltar i Gjergj Kastriotit⁶⁰.

Malchus – Malçi

Në këtë rast grykorja [k] është qiellzorizuar duke na dhënë [tʃ] për shkak të i-së në trajtën e shquar (*Malki>Malçi). Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipes në fakt na dëshmon se grykoret [k] dhe [g] në trajtën e shquar marrin [i] vetëm në zonën e gegërishtes verilindore, jo në territore të tjera të banuara nga shqiptarët, por anketat e këtij atlasi janë të viteve dymijë, jo historike⁶¹.

Në të vërtetë, mendojmë se kjo dukuri fonologjike ka qenë mjaft e përhapur dhe sadoqë të dhënat mungojnë, prapsepapë do të mundohemi të përcaktojmë dy kufij të saj në kohë dhe në hapësirë. I pari, si formë grafike e konsoliduar, është *Musachia* (> Myzeqe) siç del tek historia e Gjon Muzakës (1510)⁶². I dyti lidhet me fjalën *dyfek*-i te «Kanga e Kara Mahmut Pashës kur desh me pushtue Martaneshin» (fundi i shek. XVIII)⁶³.

Në të dy rastet [k] ndiqet nga [i] në trajtën e shquar në Ultësirën perëndimore, i pari, dhe në Shqipërinë qendrore, i dyti.

Një shembull tjetër është mbiemri *Muzhaqi* < *Muzaki*, në afërsi të Thumanës. Ndërsa më në veri, na del edhe sot e kësaj dite toponimi *Shmarçaj* < *Shën Mark*, një lagje e qytetit të dikurshëm të Drishtit.

Prap, një tjetër mbiemër që na vërteton këtë dukuri fonetike është edhe ai i familjes *Saraçi*, ende sot banuese në Shkodër. Në «Matrikullin e Shkollës së Arbërve»⁶⁴ shfaqet emri i gastaldit shkodran Pietro Saraco-s [Pjetër Saraçit]. Edhe në këtë rast qiellzorizimi ka ndjekur rrugën *Saraki>Saraçi. Ndërsa për mbaresën /-o/ tek *Saraco/Saracco* e cila del në origjinalin e «Matrikullit», duhet të kemi parasysh se emri është italianizuar nga përkthimi. Gjithashtu, nuk mund të përjashtohet se etimologjia e këtij mbiemri buron nga fjala *saragë*, cironka ose gjuhca (*alburnus albidus alborella*) kur i nënshtrohet procesit të tharjes⁶⁵. Siç shihet pra, mbiemri

60 M. SIRDANI, *Skanderbegu mbas gojëdhanash*, Shtypshkroja françeskane, Shkodër 1926, 43-44.

61 *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vep. cit., harta 195.

62 «Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi, (1510)», tek Ch. HOFF, *Chroniques gréco-romanes*, Berlin 1873. Krhs., Andreas de Musachio (1281), tek AA, I, dok. 454, 134.

63 «se shtatë vjeç djali rrok dyfekin», tek *Visaret e Kombit*, Shtëpia Botonjëse «Kristo Luarasi», vëll. IV, Tiranë 1939, 3.

64 L. NADIN, vep. cit., 72.

65 G. D. POLJAKOV – N. FILIPI – K. BASHO – A. HYSENAJ, *Peshqit e Shqipërisë*, Universiteti shtetëror i Tiranës, Tiranë 1958, 268. Shih edhe: *Fjaluer i rii i Shcypës*, Bashkimi, Shkoder 1908, 390.

Saraçi në zanafillë nuk ishte homonim me fjalën me burim turk «saraç»⁶⁶, aq më tepër kur bëhet fjalë për banorë shkodranë që ishin larguar para pushtimit osman të Shkodrës.

Këta shembuj na dëshmojnë se [k] është ndjekur nga [i] në trajtën e shquar të emrave në një zonë shumë më të gjerë nga ajo që na paraqet sot atlasit dialektologjik.

Duke u kthyer te dy shenjtoret Kozma dhe Damian, mjekë, mund të shtojmë se këtyre u janë kushtuar shumë kisha në Mesjetë. Sot në Shkodër dhe përqark nuk gjejmë kisha por mund të pikasim tri toponime që lidhen me këta shenjtore. I pari, në veri të Shkodrës është fshati Vrakë < Sant Auracio⁶⁷ që vjen nga serb. Sveti Vrača – *Mjekët e Shenjtë*. Simetrikisht me këtë dhe i baraslarguar nga qyteti i Shkodrës, në jug, gjendet fshati Kosmaç, emri i të cilit buron nga emri i këtyre shenjtorëve, pajtorë të këtij fshati. (Si analogji me faktin se një fshat mban emrin e shenjtorit që nderohet aty, krejt afër Kosmaçit kemi fshatin Stajka – me një [j] epentetike – i cili ka pasur pajtor Shën Eustakun.⁶⁸)

Është tepër e rëndësishme për fonologjinë e serbishtes të vihet re se në gjuhën shqipe, toponimi ka hyrë i paqielzorizuar (shq. *Vraka* < serb. **Vrakia*), fakt që ndihmon për përcaktimin në kohë dhe hapësirë të dukurisë së qiellzorizimit të grykoreve të serbishtes jugore⁶⁹. Studimi më i thellë i dinamikave të qiellzorizimit në serbisht dhe shqip mund të çojë në zbulime interesante për të dyja gjuhët⁷⁰.

I treti toponim që lidhet me Shën Kozmain dhe Damianin gjendet në jug-perëndim të Shkodrës, në Mal të Zi. Është fshati Shas (serb. *Svač* < *Sveti Vrača*).

Tjetër kishë kushtuar Shën Kozmait dhe Damianit gjendej në Manati, Lezhë, tashmë e shkatërruar nga turqit siç del nga një relacion i imz. Benedikt Orsinit, raguzan, ipeshkëv i Lezhës, në vitin 1629⁷¹.

66 *Fjalor i gjuhës shqipe*, vep. cit., 485.

67 F. CORDIGNANO, *Catasto veneto di Scutari e registrum concessionum*, stabilimento grafico «Carnia», Tolmezzo 1944, 77. Shih edhe: M. ŠUFFLAY, vep. cit., 153.

68 Janë të shumtë emrat e fshatrave ose të qendrave të banuara që mbajnë ende sot emrin e pajtorit të dikurshëm. Disa nga këto toponime janë krejt të zbërthyeshme si përshebull: *Shijak* < *Shën Jakë*, *Shpal* < *Shën Pal*, *Shijon* < *Shën Gjon*, *Shënnapremte* < *Shna Premte [Sancta Veneranda]*. Të njëjtën aferezë ka pësuar edhe fjala lat. *ëpistola* > shqip *pistulli(-a/në)*. Shih: E. ÇABEJ (botim kritik), «*Meshari*» i *Gjon Buzukut (1555)*, Tiranë 1968, II, *passim*. Krejt afër me Stajkën dhe Kosmaçin gjendet edhe fshati Pistull.

69 Shih edhe shën. 19 ku në origjinalin serbisht toponimi *Vrakë* del si *Vrača*.

70 Krhs., mne/srb. *Bečič(i)* < **Bečik(i)* dhe mbiemrin shq. *Beçik/-emi/*. Rreth prapashtesës /-eme-; -m-/ shih: A. XHUVANI — E. ÇABEJ, vep. cit., 34-35. Rreth qiellzorizimit I të serbishtes, shih: A. BELIĆ, *Osnovi istorije srpskohrvatskog jezika i fonetika*, četvr. izdanje, Beograd 1976, 1), 111.

71 I. ZAMPUTI, vep. cit., vëll. I, 401.

Duke u kthyer prap tek emri *Malç*, po shtojmë se në zonat e tjera të Shqipërisë ku grykorja [k] në trajtën e shquar të emrave nuk është ndjekur nga [i] por nga [u], emri *Malchus* ka mbetur i pandryshuar. Kështu e gjejmë edhe sot si mbiemër familjeje: Malk[-o/-aj].

Nga lista e këtyre emrave hipokoristikë arbërorë që përmendëm, emri *Llesh*, përveç se në *acta*-t mesjetare, gjendet edhe i gdhendur (por jo i përkthyer) serbisht në rrasën e varrit të njërit të ndërtuesve të kishës së manastirit të Komit, buzë liqenit të Shkodrës në Mal të Zi.

ГНА ПЛОЧА ДЕСПОТА СТЕПАНА БОЕКОВЕ МД АЛЕША ЦРНОЈЕВИЧА.⁷²

Edhe ky shembulli i fundit na nxit t'i përkthejmë dhe t'i kuptojmë drejt emrat e arbërve në Mesjetë e më vonë. Kështu për shembull, një skulptor me famë i Rilindjes Europiane ishte edhe Andre Lleshi, gjë që na e vërteton edhe titulli i një artikulli plot të dhëna rreth këtij artisti⁷³. Në atë artikull, ku në të gjitha dokumentet e përmendura mbiemri i artistit del si *Alex[is]*, autori prof. Petar Kolendić në titullin e përdorur ka ditur ta çojë mbiemrin e këtij në trajtën arbërisht.

Në mbyllje, po nënvizojmë çka pohuam në fillim të këtij studimi se noterët i kanë përkthyer emrat prandaj edhe përkthyesit ose studiuesit e sotëm duhet të jenë të ndërgjegjshëm për këtë fakt dhe të përcjellin një interpretim sa më të saktë onomastik kur bëhet fjalë për dokumente të Mesjetës.

BIBLIOGRAFI

ARCHIVUM FRATRUM PRAEDICATORUM, Santa Sabina, Romë, *Liber PP, Secunda Pars, Monumenta Congregationis S. Dominici de Ragusio Ord. FF Praedicatorum*, (CERVA Serafino, ca. 1756).

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Università degli Studi di Napoli L'Orientale, vëll. I, 2007.

BARTL Peter (herausgegeben und bearbeitet von), «Albania Sacra: Geistliche Visitationsberichte aus Albanien 1: Diözese Alessio», tek *Albanische Forschungen*, 26, 1, Wiesbaden 2007.

BELIĆ Aleksandar, *Osnovi istorije srpskohrvatskog jezika i fonetika*, četvr. izdanje, Beograd 1976.

CORDIGNANO Fulvio, *Catasto veneto di Scutari e registrum concessionum*, Stabilimento grafico «Carnia», Tolmezzo 1944.

72 *Kjo rrasë [është] e Llesh Cërnojeviqit vojvodë i despot Stefanit*, tek L. STOJANOVIĆ, *Stari srpski zapisi i natpisi*, knj. I, 70. Beograd 1902, dok. 232, 74.

73 P. KOLENDIĆ, «Dokumenti o Andriji Alešiju u Trogiru», tek *Arhiv za arbanasku starinu*, knj. 2, (1924), Beograd 1925, 70.

- CORDIGNANO Fulvio, *Onomasticon del catasto veneto di Scutari e registrum concessionum*, Stabilimento grafico «Carnia», Tolmezzo 1945.
- COTRUGLI Benedetto, *Della mercatura et del mercante perfetto*, IV, Venegia, 1573.
- ÇABEJ Eqrem (botim kritik), «*Meshari*» i *Gjon Buzukut (1555)*, Tiranë 1968, II.
- ÇABEJ Eqrem, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, bleu IV, Tiranë 1996.
- ÇABEJ Eqrem, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, bleu III, Tiranë 1987.
- DABAJ Gjakë, *Shestani*, vëll. II, Ulqin-Tiranë-Prishtinë 2004.
- DAKA Palok, «Rreth disa antroponimeve të hershme shqiptare», te *Studime Filologjike*, Tiranë 1984, nr. 3.
- DEMIRAJ Shaban, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1996.
- FABIETTI Ugo, *Elementi di antropologia culturale*, Mondadori, Milano 2010.
- FARLATI Daniel – COLETI JACOBUS, *Illyricum Sacrum*, Venetiis 1817, tom. VII, 401.
- Fjalor i gjuhës shqipe*, Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës dhe i Letërsisë, Tiranë 1954.
- Fjaluer i rii i Shcypés*, Bashkimi, Shkodër 1908.
- GURAKUQI Gaspër, «Blinishti», *LEKA*, Shkodër 1931, vjeti III, nr. 5.
- HOPF Charles, *Chroniques gréco-romanes*, Berlin 1873.
- <https://www.aktuelno.me/magazin/perast-tradicionalno-okitili-mad-u-slavu-prolječne-radosti-zivota/>
- KOLENDIĆ Petar, «Dokumenti o Andriji Alešiju u Trogiru», tek *Arhiv za arbanasku starinu*, knj. 2, (1924), Beograd 1925.
- KOSTALLARI Androkli — DOMI Mahir — DAKA Palok — MANSAKU Seit (përgat.), *Fjalor me emra njerëzish*, 8 Nëntori, Tiranë 1982.
- LAMBERTZ Maximilian, *Die Volksepik der Albaner, der Zyklus von Mujo und Halil*, tek «Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl Marx Universität Leipzig», 4 Jahrgang 1954-56.
- LECCISOTTI Tommaso (a cura di), *Abbazia di Montecassino, I registri dell'Archivio*, vol. III, Roma 1966.
- MANN Stuart E., *An Albanian Historical Grammar*, Buske, Hamburg 1977.
- MIKLOSICH Franz (edidit), *Monumenta serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnia, Ragusii*, Viennae 1858.
- NADIN Lucia, *La Matricola della Scuola degli Albanesi*, Berk, Tiranë 2022.
- NDRECA Arben, «Emni “Kastriot” në një letër serbisht të vjetit 1368», te *Shejzat-Pleiades* 3-4, Tiranë 2018.
- NDRECA Arben, «Sacer Panniculus Christi – Shpërgani i Krishtit Foshnje që la në Raguzë Gjon Arbnori në vitin 843», te *Shejzat-Pleiades*, 3-4,

- Tiranë 2020.
- OSTOJIC Ivan, *Benediktinci u Hrvatskoj i ostalim našim krajevima*, Split 1963.
- POLJAKOV Georgij D. – FILIPI Ndoc – BASHO Kozma – HYSENAJ A., *Peshqit e Shqipërisë*, Universiteti shtetëror i Tiranës, Tiranë 1958.
- RROTA Justin, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime françeskane, Shkodër 2006.
- SAKCINSKI Ivan Kukuljević (izdaje), *Codex Diplomaticus regni Croatiae, Slavoniae et Dalmatiae*, dio 2, knjiga 3, Zagreb 1875.
- SCIAMBRA Matteo – VALENTINI Giuseppe – PARRINO Ignazio, *L'Albania e Skanderbeg nel piano generale di crociata di Callisto III (1455-1458)*, Badia di Grottaferrata 1967.
- SIRDANI Marin, *Skanderbegu mbas gojëdhanash*, Shtypshkroja françeskane, Shkodër 1926.
- STOJANOVIĆ Ljubomir, *Stare srpske povelje i pisma, knjiga I, Dubrovnik i susedi njegov, prvi deo*, Beograd – Sremski Karlovci 1929.
- STOJANOVIĆ Ljubomir, *Stari srpski zapisi i natpisi*, knjiga I, Beograd 1902.
- ŠUFFLAY Milan, *Serbët dhe arbërit*, Berk, Tiranë 2022.
- TOPALLI Kolec, *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 2004.
- TOPALLI Kolec, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e studimeve albanologjike, Tiranë 2017.
- THALLÓCZY Ludovicus – JIREČEK Constantinus – ŠUFFLAY Emilianus (collegerunt et digesserunt), *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, I & II, Vindobonae 1913, 1918.
- THEINER Augustino, *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium*, tomus primus, Romae 1863.
- VALENTINI Iosephi, *Acta Albaniae Iuridica*, tomus II, Rudolf Trofenik, München 1973.
- XHUVANI Aleksandër – ÇABEJ Eqrem, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962.
- ZAMPUTI Injac (përkth. dhe përgat.), *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII*, vëll. I (1610-1634), Tiranë 1963.
- ZAMPUTI Injac (përkth. dhe përgat.), *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shekullin XVII*, vëll. II (1634-1650), Tiranë 1965.